

KOSOVARJA

Ballina: Drita Zumberi

**Këngëtari
që u rritë
afër eshtrave
të Isa Boletinit**

Cilat janë "foret"
e vajzave që ikin

DRITA ZUMBERI

magjistre,
grua dimensionale,
humane

**Këngëtaret tona
që u martuan
në adoleshencë**

Histori
dashurie
nga skena
shqiptare

**UB për
investime
serioze në
vendlindje**

Kompania
"Kelmendi GmbH"
në Panairin SIAL
në Paris

remos

DENTFIX

SHERWOOD

BREZOVICA

allüre

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

MOLLA

Shkenda Dëshmor

Banaderm

MARITIM

CIMA

Një oazë e vërtet
relaksi, dizajn
luksi, zgjedhje
unike dhe
elegante,
**KERAMIKË
DHE
SANITARI**

AMBIENT CILËSORË

 **DINO
KERAMIKA**

ST
O
Z
E
N
E
N



**Magjistre,
grua dimensionale,
humane**

Në ballinë: Drita Zumberi

Drita Zumberi është një nga femrat shqiptare të suksesshme në botë, e lindur dhe e rritur në Gjermani, e cila nuk ka preferuar ndonjëherë që biografinë e saj ta nxjerrë në dritë, sukseset e saj t'i flasë me zë. Janë më tepër miqtë, komuniteti, kolegët, të njohurit, ata që flasin për Dritën, intelektualizmin, zotësinë profesionale dhe bashkëngjitjen e saj në aktivitete humanitare, konkretisht në Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”.

Drita ka studiuar në Katedrën e Gjuhës Shqipe në Mynhen të Gjermanisë, ndërkaq në vitin 2003 e ka mbrojtur magjistraturën në Ludwig-Maximilian, në Universitetin e Mynihut, me temën “E folmja e Preshevës dhe ndikimi sllav”.

Për të ishte eksperiencë tejet e mirë të ishte studente e vendasit të saj, Akademik Prof. Dr. Rexhep Ismajlit.

Zumberi prej vitesh punon në media, përkatësisht në radion gjermane “ARD”, redaktore në redaksinë e lajmeve.



DRITË MBI DRITA ZUMBERIN

Familja e Drita Zumberit është nga një fshat i rrethit të Preshevës, i cili është në mes të zonës, korridorit 10, që lidhë Evropën me Azinë. Siç kuptojmë, rrjedh nga një familje e madhe, nga të dy anët e prindërve. Pjesa dërrmuese e familjes së saj, kryesisht, jetojnë në Evropë e gjetiu.

Është e martuar me Claudius Artz, avokat i njohur në Gjermani dhe i kanë dy fëmijë, Aurelin e Gertianin. Dhe, ani pse nuk ka lindur në tokën e të parëve, Drita ka pasur kureshtjen e madhe për të studiuar gjuhën amtare dhe sot e kësaj dite shkollimi mbetet pjesa më e bukur e jetës për të.

Tash Drita ka një pozitë me shumë përgjegjësi në një nga mediet më prestigjioze në Gjermani, në "ARD Radio", redaktore e lajmeve. Por, edhe në këtë punë sfiduese atë e karakterizon natyrshmëria dhe të qenit e gjithanshme...

Mirëpo, edhe pse ka magjistruar në Gjuhë e Letërsi Shqipe, Sllavistikë dhe Gjermanistikë, që dy dekada punon në media, qysh prej kohës së luftës në Kosovë. Ndërkohë, kjo grua e zonja, sfidat i konsideron eksperiencia, pasi, siç thotë gjatë muhabetit, ato të shtojnë të ecësh përpara, të mos dorëzohesh.

Fundja, puna që ajo bën në përditshmërinë e saj është sfiduese dhe plot dinamizëm. Dhe, ndonëse e shkolluar dhe e pozicionuar në mënyrë ideale në anën profesionale, Drita potencon se ambiciet e saj nuk ndalojnë kur bëhet fjalë për shkollim dhe punë.

PUNA E SAJ SI HUMANISTE

Përtej të gjithave, është grua që e do kombin e vet, por edhe humanizmin. "Unë, si Dritë, në jetën e përditshme, qysh nga kohët e mëhershme, e kam ndjerë në shpirt t'u ndihmoj njerëzve me kushte të vështira, grave kryefamiljare, studentëve, e kështu me radhë.

Humanizmi për mua ka peshë dhe rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në jetë. Me këtë akt njeriu prek çdo cep, ndjen se si është të jesh si ta, jeton nga buzëqeshja e tyre, madje frymëzohesh edhe më shumë për t'i ndihmuar pafund", thotë për aktivitetin e saj humanitar.

Zumberi është zëvendëskryetare e Shoqatës "Jetimat e Ballkanit", është aktive në këtë drejtim dhe puna e saj nuk ka të ndalur në Kosovë, por edhe në Luginë të Preshevës.

Nëpërmjet Shoqatës "Jetimat e Ballkanit" kanë arritur të inicojnë ndërtimin e 40 shtëpive në Luginë, përfshirë të tri komunat: Preshevë, Bujanoc e Medvegjë.

"Fusha e humanizmit, disi, më bën të ndjehem më e lumtur, më e qetë. Thjesht, e dua dhe e bëj me dëshirë".

Për shqiptarët thotë se është gjithmonë kënaqësi të flasësh, meqë jemi popull i mirë, ani pse të vuajtur e të dërrmuar me shekuj nga zullumet e torturat e armikut.

Dhe, pavarësisht të gjithave, shqiptarët kanë mbetur popull empatik, human dhe me besë. Andaj, pavarësisht rrjedhave të përditshme, kriti-



kave politike drejtuar njëri-tjetrit, kjo në sytë e Dritës së lindur e rritur në Gjermani nuk i bën shqiptarët asnjëherë të këqij. Sepse, kjo grua e zonja dhe e suksesshme ka admirim për femrat shqiptare dhe sukseset e tyre në botë, femrat intelektuale që po prezantohen denjësisht kudo.

“Kur jemi te këshillat, në përgjithësi tek femrat shqiptare nga këndvështrimi im, është mosdorëzimi në asnjë mënyrë as në jetë e as në politikë, as në familje e askund, se jemi komunitet stabilizues, në radhë të parë në familje, por edhe në punë e në fushëveprime të tjera”, shton Drita, e cila femrën shqiptare e konsideron të fortë, besnike e humane.

Për të Nënë Tereza është shembull i gruas së fortë shqiptare, ani pse mendon se kemi edhe shumë gra të tjera të kohës moderne që po na përfaqësojnë denjësisht nëpër botë.

JETA PRIVATE...

Po, jeta private e Drita Zumberit cila është? Ndër vite ka preferuar të flasë pak për veten, e edhe më pak për jetën e saj private...

“Pak flas për jetën time private, sepse disi ndjehem komode të mos flas, sepse jeta private është imja. Jetoj mirë me bashkëshortin, të cilin e falënderoj tej mase për respektin që tregon në përditshmëri.

Ai rrjedh nga një familje gjermane dhe jemi të komunitete dhe kulturave të ndryshme. Por, jeta jonë është shumë e qetë dhe me harmoni të plotë.

Dua të them me shumë modesti se bashkëshorti im, Claudius, është edhe shoku im në jetë e në profesion.

Pos përkrahjes që më jep si bashkëshort e nënë e fëmijëve tanë, ai më ndihmon edhe në jetën profesionale, konkretisht në Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, ku me ndihmën e tij, në cilësinë e juristit dhe avokatit me eksperiencë gjermane, me avokaturën e tij “Artz&Partner” në Mynhen dhe Berlin, më ndihmon edhe si avokat në Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, ku unë veproj me shumë kënaqësi.

Thjesht, përkrahja dhe respekti i tij është i pashoq për mua dhe gjithë popullin tim”, thotë Drita Zumberi, grua shumë dimensionale, intelektuale, humane, e cila pavarësisht angazhimeve, vorbullës së punës, asnjëherë nuk e humbë elegancën prej femre të bukur.

Nderim Neziri



Kosova është bërë si hani i kalit!

Kur i dëgjon njeriu disa politikanë dhe deputetë tanë se si flasin në parlament për tema të mëdha, duken aq patriotë sa që të gjithë kundërshtarët rreth tyre shihen si tradhtarë...

Rastisa ta dëgjoja një njeri në një ndejë kah fliste kundër komunizmit. Doktor me titull. I doktoruar në komunizëm. Por, fliste keq për komunizmin! Nisi t'i kritikojë, pastaj, doktorët e rinj. Dhe, kur e kreu "ligjëratën", njëri i tha: "O doktor, e dimë që je emër i njohur, por kur e ke kryer fakultetin?".

"Moti, hyyyyy, në kohën e Jugosllavisë!", tha ai.

"Pra, ti e ke kryer fakultetin në kohën e komunizmit dhe, falë atij komunizmi, je doktor me emër të njohur. Në komunizëm ka qenë më mirë për shkollim e dije...

E, sot, po pate të njohur, e që të përkrahin, ecë edhe pa pasur fare diplomë. Gjen vend të mirë pune, të bëjnë, madje, edhe ministër! Por, që t'i fitosh këto privilegje, duhet të jesh pjesëtar i ndonjë partie që

është në pushtet! Pra, si në komunizëm!

Në atë kohë më shumë ka kryer punë një karakteristikë pune sesa një diplomë. E, edhe tash njëjtë. Më shumë kryen punë po të kesh të njohur, sesa të kesh titull doktorate", i tha po i njëjti.

Pra, disa njerëz, në kohën që po e jetojmë, kanë para dhe mendojnë se janë të pazëvendësueshëm. Kur i dëgjon duke folur e kritikuar për gjithçka, thua se këta nuk kanë qenë pjesë e shoqërisë sonë deri më tash!

DISA POLITIKANË FLASIN BUKUR, A REZULTATE S'KANË!

Nuk është çudi pse disa politikanë tanë flasin bukur e suksese s'kanë fare.

Sepse, të tillët janë mësuar vetëm të flasin, e të punojnë nuk dinë!

Në anën tjetër, disa politikanë e deputetë tanë vetëm kritikojnë, e asgjë në dritë nuk qesin.

Pra, me të drejtë mund të thuhet se Kosova është bërë si hani i kalit. Kushdo lodron kah të dojë vetë...

NUK LEXOJMË A DIMË SHUMË!

Duhet të pranojmë se ne, si popull, nuk lexojmë ose lexojmë pak. E, të gjithë "dimë"! Dhe, njerëzit që nuk lexojnë, nuk dinë ta thonë të vërtetën. Ata realen e zëvendësojnë me konspiracion.

E, kur diçka konspiron, do të thotë se je duke bërë shpifje. Dhe, askush nuk ta zë për të madhe e qëllave a jo...

Diturie Haxhaj

SA DURON SHPIRTI?

Vrasja e kohës është vetëm një emër, për mënyrën tjetër se si koha na vret neve...



PSE MERREMI ME VETVETEN?

Nuk duket racionale përherë ta fajësojmë historinë, ta fajësojmë Evropën e botën për padrejtësitë ndaj kombit dhe popullit tonë. Këto fajësime nuk janë kontestuese. Po që se vazhdojmë të merremi me vetveten, do të pranojmë logjikën vetë-rënuese. Gjendja në të cilën jemi nuk mund të përballohet as lehtë e as shpejt pa bashkimin e forcave. Po që se këtë nuk e bëjmë, do të ballafaqohemi me plasaritje dhe ndarje të reja. E, plasaritjet dhe ndarjet, populli dhe kombi shqiptar i ka paguar shumë shtrenjtë në të kaluarën. Ekziston rreziku që këto të tashmet t'i paguajmë edhe më shtrenjtë...

*

Me politikë duam të merremi të gjithë, edhe pse marrja me politikë kërkon prirje të veçantë. Politika nuk është zeje që mësohet, por shkathtësi që lindë dhe zhvillohet.

*

Partitë tona të habitin: gabimet e partive të tjera i shohin, ndërsa gabimet e veta nuk i shohin! Partitë, të cilat për vetvete mendojnë se janë të pagabuara, gabojnë qysh në fillim. Koha po ecë... Po ashtu, edhe mospajtimet po vazhdojnë dhe veç çka po ashpërsohen edhe më shumë.

KUSH MUND TA HARROJË TË KEQEN?

Armiku me të cilin je pajtuar apo do të pajtohesh,

zakonisht, nuk është më i mirë, sepse xhami i thyer s'ngjitet...

Thonë: e mira harrohet, kurse e keqja ruhet me ngulm në kujtesë. E, sa kohë mund të shkojë që të harrohet e keqja? Të keqen mund të harrojnë vetëm ata që nuk kanë plagë. Kurrë ata që ende kanë dhembje, që ende plaga u kullon...

FUNDVJESHTË

Thonë: bashkë me stinët ndërrojnë edhe njerëzit. Edhe dashuria. Edhe lumturia shpirtërore. Në këtë fundvjeshtë kudo e kah do sheh gjethe shumëngjyrëshe... Gjithçka shkon drejt zbehjes... E, njeriu sikur ndien nevojë t'ia qajë hallin dikujt, brennat, dashjet... Ndien nevojë t'ia çelë dikujt zemrën, ta lehtësojë veten. Me zemër të çelur, thonë, ndihesh më i lirë.

Megjithatë, diçka mbetet edhe nga stina e zbehtë, s'harrohet dot, kujtohet... Andaj, as në këtë fundvjeshtë s'dua që gjithçka e shkuar të harrohet, por as të kthehet, se në jetë ka edhe shumë dhembje dhe a do të mund t'i durojë shpirti?

*

Asgjë nuk mund të zgjatë përgjithmonë As dhembja, as gëzimi As dashuria, as pikëllimi As jeta.

*

Thonë, njeriu është i ngjashëm me detin, sepse të dy janë tinzarë dhe s'dihet çfarë kanë brenda. Pra, njeriu dhe deti, dy fshehtësi të mëdha...

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Pse jemi popull i çuditshëm?

Edhe më i keqi të vret! Ruana Zot prej gazetarëve analfabetë!

Jemi popull i çuditshëm! Pse?

Një, sepse ia ka dhënë votën për qeverisje shumëkujt që nuk e ka merituar!

Dy, ka kryetar komune që nuk di matematikë reale e as matematikë politike!

Tre, ka njerëz që e udhëheqin shtetin, të cilët kurrë nuk kanë qenë as zot të shtëpisë së vet dhe nuk e kanë mbajtur as kuletën e shtëpisë dhe nuk dinë sa kush-ton vaji, djathi...

Pra, të tillët janë bërë menaxhues shteti për të udhëhequr atë që nuk u takon! Ka njerëz që janë tepër agresivë, e edhe policë që e kanë vënë revolen në brez dhe i imitojnë kreshnikët si në këngët e Mujës e Halilit!

Pra, nuk thonë kot: "Edhe më i keqi të vret!"

Dhe, kur jemi te më i keqi, po e ilustruj me një shembull, të cilin e di me emër dhe mbiemër, por që po e kursej...

Një burrë shkurtbajq fejoj me një vajzë në vitet 70. Dhe, ditë pas dite babai i vajzës e kupton se dhëndri ishte i shkurtër shumë dhe do e prishë fejesën. Shkurtbajqi i thotë se për robin qes pushkë.

Dhe, fjalë pas fjale, një ditë shkurtbajqi i del në rrugë babait të së fejuarës dhe i thotë se e do robin.

Ai e kërcënon shkurtbajqin dhe i thotë se ti për t'më frikësuar mua duhet të rritesh sa unë.

Shkurtbajqi nxjerr revolen dhe shtie në të dhe e vret.

Kur dorëzohet në polici, i thonë:

"Bujrum, aga efendi! Çka të ka sjellë Zoti këtu?!"

"E kam vrarë një njeri!", ua kthen ai.

Policët nisin të qeshin.

"Ti e ke vrarë dikë?!", thonë me habi.

"Po, unë e krevia misionin tim!", ua kthen ai.

Kur dalin në vendin e ngjarjes shohin se e vërteta ishte siç thoshte shkurtbajqi...

RUANA ZOT PREJ GAZETARËVE ANALFABETË!

Gjatë rrugës me veturë, teksa dëgjoj një raport për punën e Kuvendit të Kosovës, gazetarja raporton duke e ngatërruar fjalën "organizativ" në vend të fjalës organizim.

U befasova me gazetaren që udhëhiqte programin. U befasova me faktin se deri ku ka shkuar analfabetizmi gazetaresk! Sidoqoftë, dikur kishte pak gazetarë, e sot ka sa të duash. Sot nga gazetarët të gjithë ikin...

E, kjo më ngjanë në një të kaluar interesante:

Në Shkodrën e kohës së Enver Hoxhës, më thotë një shkodoran, kanë qenë vetëm shtatë policë. Më mirë të themi një polic për një lagje.

Një herë në muaj polici hynte në lagje dhe ata që ishin të dobët prej zemre vdisnin! E, tash Shkodra ka me qindra policë dhe të zezat nuk ndalen...

Pra, zbatimi i ligjit është kryesori. Sepse, kur shteti e zbaton ligjin, të zezat tretin. Sidoqoftë, të mendojmë ndryshe lejohet në demokraci, por të mësohemi me demokraci është shpesh si të mësohemi me varfërinë...

Një varfanjak i afrohet një fallxhiu dhe e lut t'ia shikojë dorën për të parë nëse do e kalonte varfërinë. Fallxhiu i thotë:

"Sivjet do jesh fukara!"

"Pa shiko vitin tjetër si do të jetë?"

"Edhe vitin tjetër do të jesh fukara!"

"E tjetrin?"

"Eh, tash po del pak më mirë!"

"Pra, falë Zotit, pas tre vjetësh do nisë e mira edhe për mua, a?! Çka do të fitoj dhe sa do të bëhem i pasur?"

"Nuk do bëhesh i pasur, por mësohesh me varfërinë!"

DIKUJT DO I LUHET NËNA!

Dikur, kur bëheshin miqësitë deri në disa ditë larg,

një prind i kishte dhënë dy vajzat e veta në të njëjtin fshat të largët.

Pas një kohe babai mori rrugën t'i vizitonte vajzat dhe arriti te e madhja. Kur shkoi te dhëndri i madh, e pyeti:

"Si po jetoni dhëndër? Me çka po mbetni gjallë?"

"Po mbarojmë qerpiçë. Mirë po na shkon puna. Por, nëse bie naj rrebesh i madh na e luan nënën!"

Pastaj, shkon te dhëndri tjetër dhe i thotë:

"Me çka po merrni dhëndër?"

"Kemi mbjellë specat. Por, nëse nuk bie shi, do na e luaj nënën!"

Dhe, kur kthehet në shtëpi, gruaja e pyet:

"Si ishin vajzat?"

"Mirë ishin, por njëjës po iu luajke nëna patjetër!"

Sokol Murturi

MARITIM
RESORT MARINA BAY



Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri



E paperëndueshmja **Agnesë**

Nëse ka një mis që i ka rezistuar kohës dhe ka ditur që titujt e fituar në spektakle bukurie t'i shfrytëzojë mirë, atëherë ajo është Agnesa Vuthaj.

Ka studiuar, ka punuar shumë në botën e spektakleve dhe biznesit dhe ka realizuar me qindra udhëtime të paharruara.

Agnesa është bukuroshja që i bënë të gjitha dhe mbetet perëndeshë e bukurisë.

Dora *e Diellza Kolgecit* *ndihmon skamnorët*

Diellza Kolgeci është nga fytyrat publike që nuk ngurrojnë ta zgjasin dorën për ata që kanë nevojë. Ndryshe nga shumë të tjerë, Diellza është kundër reklamimit të tepër të dhënies së ndihmës.

"Ndoshta, të tjerët që më njohin, do të përgjigjeshin më mirë në pyetjen sa jam humane, sa ndihmoj. Më duket e vështirë të flasë vetë për këtë çështje. Por, megjithatë, mendoj se të qenit human tregon edhe atë se çfarë gjene ke trashëguar, në çfarë fryme je rritur dhe edukuar", thotë ajo në një bisedë më të gjatë për revistën tonë "Kosovarja".



“The new life of Mariana Kondi”



Sustat e kolagjenit
Kirurgjia pa bisturi

Transformation Allure Beauty

Ushtaraku i KFOR-it konvertohet në mysliman dhe martohet me shqiptare

Më 20 qershor të vitit 2006, në xhaminë "Hoxhë Sinan Pasha" në Kaçanik, nën udhëheqjen e ceremonisë konvertuese të efendi Florim Nezirajt, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Kaçanikut dhe në prani të Llokman Hoxhës dhe Bujar Dervishit, pranoi fenë islame kapiteni i KFOR-it, Bartolomiej Urban, i lindur më 1979, në Goldap të Polonisë, për të finalizuar martesën me vajzën shqiptare nga Runjeva e Kaçanikut.

Si rrallë kund, Kaçaniku ditën frymon më shumë me besimtarë sesa me dinamikë tregu dhe pune. Në qendrën e qytezës më historike të Kosovës, ku u shpall Kushtetuta e Kosovës më 1990, qëndrojnë krenare monumente dhe shtatore, besimtarë që kryejnë obligimet fetare në Xhaminë e Vjetër të qendrës, pak lumit "Lepenc". Shtatorja e Sali Bajrës para objektit komunal të Kaçanikut dhe më tej në fund të qytezës salla e shpalljes së aktit të Deklaratës Kushtetuese të Kaçanikut. Përballë kalaja e vjetër që shpreh nevojën e renovimit dhe në qendër çajtoret e mbushura me qytetarë. Qyteza e Kaçanikut njihet edhe për të bëmat e saj në luftën e njohur "Lufta e Grykës së Kaçanikut", kur Dervish Pasha, më 1881, me afër 20 mijë trupa xhonturq, kishte marrë rrugën për ta shuar lëvizjen kryengritëse të Prizrenit, por duke

lënë shumë të vrarë në Grykën e Kaçanikut. Dhe, 140 vjet më vonë nga kjo luftë, në Kaçanik u bë një histori tjetër. Më saktë, ka ndodhur një martesë, e cila medialisht ka zgjuar kureshtjen e opinionit. Në fakt, kureshtja nuk u spikat si enigmatike vetëm se ishte martesë, por pse kaloi disa procedura, kryesisht të përmbushjes fetare myslimane, që ta kurorëzonte një dashuri të lindur mes dy vetëve: një ushtaraku polak që shërbente në "Bonstill" të Ferizajt dhe një femre shqiptare që ishte aty përkatëse.

Ç'THOTË PROF. FLORIM NEZIRAJ, KRYETAR I KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË KAÇANIK, NË KOHËN KUR E VIZITUAM? Në xhaminë e Kaçanikut "Hoxhë Sinan Pasha", një i krishterë u bë

mysliman në prani të kryetarit të Këshillit...

Është fjala e konfirmimit të një konvertimi në islam të ushtarakut Bartlomije Urban, e që mori emrin e ri Omer, pasi bëri martesë me Lumturie Kokën, nga fshati Runjevë e Kaçanikut.

Dhe, duke folur se si ka ndodhur tërë kjo, efendi Florim Neziraj, në kohën kur e vizituam, tha për revistën tonë, "Kosovarja", se konvertimi në islam i kapitenit Omer, që kishte shërbyer gjashtë muaj në KFOR, ka kaluar nëpër procedura që ai me vetë dëshirë e ka pranuar fenë islame si fe të veten, duke hequr dorë nga feja e tij e deriatëhershme.

"Në zyrën e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kaçanikut, ushtaraku me kombësi polake, ka pranuar fenë islame si fe të veten, duke iu përmbajtur rregullave konvertuese islame", thotë imami Florim Neziraj.

E, ai realitet është realizuar pasi kapiteni polak është njohur me përkthyesen Lumturie Koka, nga fshati Runjevë i Kaçanikut dhe ka kërkuar konvertim. Por, sipas rregullit islam, ai duhej paraprakisht të kishte kryer synetin te kirurgu dhe atë obligim e kishte përmbushur konfrom rregullave, e tek pastaj është kryer ceremonia e konvertimit të tij në islam, si dhe është bërë kurorëzimi.

ME MARTESË JANË PAJTUAR EDHE FAMILJA

"Në kuadër të rregullave shqiptare të martesës nuk kanë paraqitur asnjë pengesë familja e vajzës", thotë efendi Florim Neziraj dhe shton:

"Për këtë martesë është pajtuar edhe familja. Ajo që ne dimë është se familja e Lumturisë ka qenë dakord për martesë, duke i pranuar rrethanat e krijuara para, gjatë dhe pas konvertimit. Kur i kam pyetur pse po martoheni, ata më thanë se po martohen meqë pëlqehen të jetojnë si bashkëshortë, se i ka lidhur dashuria". Ata jetojnë bashkë, në Poloni...

Safet Krivaça

Këngëtari që u rrit afër eshtrave

të Isa Boletinit

Malësori është këngëtar i njohur nga Mali i Zi, i cili një kohë jetoi dhe studioi në Prishtinë.

Të rrallë janë ata që nuk e mbajnë mend këngën e Malësorit, menjëherë pas luftës në Kosovë, me titull "Kthehuni". Ishte hit i kohës, por këngë që nuk do të zbehet kurrë, edhe pse kanë kaluar 20 vjet.


Por, t'i kthehemi titullit të këtij shkrimi. Familja e Malësorit janë nga vendbanimi shqiptar Triesh, e që për kushte më të mira jetese kishin ardhur të jetonin në Podgoricë të Malit të Zi, ku edhe është lindur Malësori, në një lagje në periferi të qytetit, në afërsi të së cilës lagje ishin një grumbull varrezash të moçme, e që në popull njiheshin si "varrezat e turqve".

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

Unioni i bizneseve shqiptaro-gjermane



Drejtori i UB-së Fadil Abdullahu viziton Panairin e Bizneseve në Vjenë

Me datën 15.10.2022, me ftesë të Kryetarit të Rrjetit të Bizneseve në Austri, z. Ylli Blakaj, Drejtori i Unionit të Bizneseve, Fadil Abdullahu, vizitoi Panairin e Bizneseve në Vjenë. Krahas takimit të Bizneseve B2B nga Austria, në këtë panair ishin të pranishëm edhe disa Kompani nga Kosova.

Fokus dhe dëshirë e të gjitha kompanive shqiptare prezentë që veprojnë në Austri e Kosovë gjithsesi se ishte edhe tregu i Gjermanisë.

Këto biznese u njoftuan nga Drejtori Abdullahu me zhvillimet e reja

te Unioni i Bizneseve në Gjermani dhe fuqizimit të saj, për të cilat ishin ngritë pritje të mëdha nga Bizneset në Austri e Kosovë, me synim bashkëpunimin për qëllime të përbashkëta.

Unioni i Bizneseve sapo të themelojë degët e saja në tërë RF të Gjermanisë, përmes stafit të saj operativ do të ndërtojë raporte bashkëpunuese, për të mirën e anëtarëve të saj, më të gjitha shoqatat biznesore që veprojnë në Vendlindje dhe jashtë saj.



Kryetari i Nazmi Viqa: UB gjithmonë i hapur për kuadro të shkolluara

Kryetari i Unionit të Bizneseve Nazmi Viqa së bashku me Drejtorin ekzekutiv Fadil Abdullahu si dhe ish Ambasadorin Skender Xhakaliu, si këshilltar i jashtëm i UB, vizituan sot Kompaninë Horn & Co në Siegen, ku u priten nga aksionari dhe Drejtori menaxhues, Argjend Kameraj.

Ishte kënaqësi e veçantë që Drejtori Kameraj, i cili udhëheqë këtë Kompani me 580 të punësuar, të bëjë prezantimin e sukseseve të Kompanisë Horn & Co e cila aktivitetin e saj afarist e zhvillon në disa fusha dhe ka një histori 100 vjeçare.

Pjesë e takimit ishte edhe afaristi shqiptar Mentor Hajdari, Drejtor nga Kompania BALD Automobile GmbH, përfaqësues i Mercedes Benz.

Edhe avokati i rrespektur nga Zyra e Oppenhoff & Partner – Köln, Dr. Nefail Berjasevic e shoqëroi këtë takim, i cili po e mbështetë profesionalisht dhe me kontakte përshtur Unionin e Bizneseve.

Kryetari Viqa përshëndeti gatishmërinë e këtyre kuadrove të reja që me punën e tyre profesionale dhe biznesore të jenë pranë Unionit të Bizneseve si promotor të zhvillimit ekonomik, dhe potencoi se dyert e Unionit do të jenë gjithmonë të hapura për kuadra e shkolluara dhe kompani që veprojnë kudo nëpër RF të Gjermanisë.

Horn & Co me partnere shqiptar dhe gjerman ka filluar disa iniciativë dhe po përgatitet edhe për investime në Kosovë.

Pra ky do të jetë njëri nga qëllimet e Unionit të Bizneseve, që përmes Kompanive dhe afaristëve të suksesshëm në Gjermani të bartet know-how, përvoja dhe një pjesë e kapitalit edhe në Vendlindjet tona.





Nënkryetari i Unionit të Bizneseve z. Gani Nuha, së bashku me Drejtorin ekzekutiv, z. Fadil Abdullahu, në ambientet e Konsulatës së Republikës së Kosovës në Düsseldorf dhe në prani të Konsulit z. Kenan Islami, pritën në një takim pune Kryetarin, z. Sheqer Ukaj dhe Drejtoreshën zonj. Arieta Vula Pozhegu nga shoqata e përpunuesve të drurit nga Kosova, të cilët ishin të shoqëruar nga përfaqësuesit/këshilltarët e GIZ-it zonj. Karen Konopka dhe z. Muhamed Bajrami.

Unioni për investime serioze në vendlindje

Temë diskutimi ishte bashkëpunimi i ndersjellët dhe shqyrëtimi i mundësive të harmonizimit të hapave të përbashkët me qëllim të krijimit të mundësive më të mëdha të plasimit të produkteve të Industrisë së drurit, made in Kosova, në tregun e Gjermanisë.

Z. Nuha, i njoftoj të pranishmit mbi strategjinë e re të Unionit të Bizneseve shqiptare në Gjermani, që përmes staftit operativ ti jepet shtytje të gjitha projekteve që vijnë nga Vendlindja dhe anasjelltas, të nxisim anëtarësinë e Unionit për investime serioze dhe të qëndrueshme në Vendlindje.

Udhëheqësit e shoqatës së përpunimit të drurit si dhe bashkëpunëtorët e tyre dhe të Unionit nga GIZ, gjithashtu u zotuan se do të na mbështesin të dy shoqatat në projektet e përbashkëta, që do të jenë në të mirë të zhvillimit të prodhimtarisë të Industrisë në fjalë në Kosovë.

Derisa Konsuli z. Kenan Islami, duke i prezentuar të pranishmëve ambientet e Konsulatës së Republikës së Kosovës në Düsseldorf, u shpreh i gatshëm ti mbajë në vazhdimsi dyert hapur të Konsulatës për takime të tilla dhe përkrahje të bizneseve nga Kosova e Diaspora.



UB në strategjinë e saj të re, *prezente në tërë territorin e RF të Gjermanisë*

Kryesia e Unionit të Bizneseve shqiptare-gjermane në Gjermani, mbajti mbledhjen e saj të parë pas Kuvendit të jashtëzakonshëm.

Kryetari, Nazmi Viqa si dhe Nenkryetari, Gani Nuha ritheksuan se Unioni i Bizneseve duhet të përcjellë strategjinë e re të zhvillimit të saj, që përmes Kryesisë, Drejtorit menaxhues me staf

operativ, Koordinatorëve dhe Degëve që do të themeloj, të jetë edhe më afër anëtarëve të saj. Të rrisë urat e bashkëpunimit mes tyre, që së bashku të bëjnë një forcë më të madhe vepruese, si në Gjermani ashtu edhe në Vendlindje.

U miratua hartimi i rregullores së punës si dhe fillimi i formalizimit të Degëve, duke filluar nga dega në Frankfurt, Stuttgart e München. Regjistrimin e zyrës ndërlidhëse në Prishtinë, përmes së cilës do të mbahen kontaktet me Kompanitë, Shoqatat dhe Institucionet në Kosovë.

Menaxhmenti u autorizua t'i shpejtoj dhe intensifikoj veprimet për anëtarësimin e anëtarëve të rinj, të cilët kanë shprehur gatishmëri të jenë pjesë e Unionit të Bizneseve.

Unioni i Bizneseve, në strategjinë e saj të re dëshiron të jetë prezent në tërë territorin e RF të Gjermanisë, dhe për këtë shtrirje është në kontakt edhe me Ambasadat dhe Konsulatat e Vendlinjëve tona, që për çështjet ekonomike të e rrisin bashkëpunimin, për cka u janë shumë falënderues për gatishmërinë e tyre dhe zotimet për mbështetjen e aktiviteteve që kanë një qëllim të përbashkët.



Kompania 'Kelmendi GMBH' në Panairin SIAL në Paris

Kompania e shumënjohur 'Kelmendi GMBH' po merr pjesë në njërin prej panairove më të mëdha të Evropës "Sial", i cili po mbahet në Paris të Francës.

Kompania 'Kelmendi GMBH' prezantoi gjithë produktet veta, tashmë të njohura edhe në tregun ndërkombëtarë. Nga dita e parë të panairit, më 15 tetor, 'Kelmendi GMBH', në "Sial" u vizitua

nga musafirët e shumtë dhe afaristë të kompanive të ndryshme. Takime të shumta u organizuan me kompani të njohura nga shumë vende të botës. Ju kujtojmë se kompania 'Kelmendi GmbH' tanimë me brendet e saja ushqimore është emër i njohur në të gjithë tregun botëror, dhe krahas industrisë ushqimore, furnizojnë klientët në Evropë, Azi dhe Amerikë. Në "Sial" këtë vit marrin pjesë rreth 7 mijë kompani nga të gjitha vendet e botës, kompani të cilat i prezantojnë produktet e tyre dhe është paraparë që numri i vizitorëve të tejkalojë shifrën e një milion vizitorëve. Panairi do të përfundojë më 19 nëntor.

KELMENDI

PLEASE VISIT US AT

SIAL

Paris

15 - 19. OCTOBER 2022
PARIS NORD VILLEPINTE

1 - H - 033

Leonora Bruçaj- Keka, *profesoreshë dhe poete*



Leonora Bruçaj u lind në Istog. Shkollën fillore dhe gjimnazin "Haxhi Zeka" i kreu në vendlindje, kurse studimet e larta i vazhdoi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës në Degën e Letërsisë Shqipe.

Ka përfunduar studimet Master në Fakultetin e Filologjisë, dega Letërsi, drejtimi Shkencor në Universitetin e Prishtinës. Ka përfunduar studimet Master në Kolegjin FAMA, drejtimi Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Ndërsa, në Universitetin e Prishtinës është në studimet doktorale në Fakultetin e Filologjisë, dega Letërsi Shqipe.

Është profesoreshë në universitetin e Gjakovës Fehmi Agani dhe në universitetin e Gjilanit "Kadri Zeka"

Përveç poezive të shumta që ka publikuar në: "Pionieri", "Gep", "Shëndeti", "Dielli", "Kosovarja", "Zëri i Rinisë", "Rilindja", "Bota e Re" dhe në revistën "Bashkimi" në Shqipëri, është dhe autore e katër librave poetikë: "Vdekja e Balozit", Prishtinë – Shtëpia Botuese "Rilindja" 1993, si dhe "Dhembje

e harresës" Prishtinë – Shtëpia Botuese "Rilindja" 1998. Libri me poezi të përkthyer në gjuhën angleze, të titulluar "Inner voice of silence", botuar nga shtëpia botuese "Lena Graphics", 2020.

Libri me poezi të përkthyer në gjuhën rumune, të titulluar "IUBIREA ÎN CĂLĂTORIE" botuar nga shtëpia botuese "Amanda Edit", Bukuresht, 2022.

Në vitin 1992 u anëtarësua në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës dhe ishte anëtarja më e re, ku u mirëprit, në vitin 1994 u zgjodh poetja më e mirë ndër poetet e reja dhe u shpërblye me një koplek librash nga Presidenti i ndjerë, Ibrahim Rugova, gjatë kohës sa ai ishte kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Është e shpërblyer me shumë çertifikata, dekorata dhe çmime nëpër konkurse të ndryshme poetike.

Në revistën letrare Jeta e Re nr-3, 2013 Prishtinë, ka botuar disa poezi. Leonora Bruçaj, po ashtu merret edhe me prozë, dhe ka një libër në dorëshkrim "Brimë politikash".

Nga viti 1999 deri në vitin 2011 ka punuar në Unmik (Misioni i Kombeve të Bashkuara) në Prishtinë. Nga viti 2010 dhe deri me tani punon si profesoreshë në Shkollën e gjuhëve të huaja "Cambridge School" dhe njëkohësisht është ligjëruese në Ambasadën Amerikane, Unmik, Kfor, MPJ, MPB, Gjykatën Kushtetuese dhe institucione të ndryshme.

Është e martuar, ka një djalë. Jeton dhe vepron në Prishtinë dhe në Gjermani.



DUET

Peizazhi i zi
në letrën e bardhë
Në guaca peshku
Ngjyrat përzihen
Në gurë lumi
Pushoj për të menduar
Pikturën
E detit të kaltërt
Qielli e deti i kaltërt
po ngjyra na mungon
I pikturoj lisat
një pëllumb më pengon
Sado që ngjyrën e vëj
Për trung
më del pëllumb
Unë pikturoj bashkë me shiun
Ku mbeti piktura ime
vetëm fleta e bardhë
Shiu ma mori simbolikën
E unë dhe shiu
Prapë pikturojmë bashkë
Kur unë s'di të pikturoj
Por simbolikën e kuptoj
Ç'mbeta unë poete
Por shiu
poezinë s'mund
të ma marrë
Edhe pse simbolikën
ia vodha...

Leonora Brucaj

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhje
Frankfurt, Këln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

BOOM

*Histori
dashurie
që lindën
në skenat
shqiptare*

*“Çenari”
tregon
prapaskenat
e serialeve
turke*

Linda,
*e suksesshmja
e fushës së bukurisë
që nuk ndalet*

*Këngëtares shqiptare
që jetojnë në shtëpitë
miliona dollarësh*

Histori dashurie që lindën në skenat shqiptare

Dashuria është ndjesia më e mirë, e cila lind në rrethana të ndryshme dhe të papritura. Ndër historitë e dashurisë më të mira konsiderohen edhe këto të personazheve të njohur shqiptarë, të cilët e kanë gjetur atë në skenën ku kanë performuar, apo ambientin e përbashkët të punës. E, dashuri të tilla ka shumë...

"Boom"-i sjell historitë më të mira të dashurisë, që kanë përfunduar me martesë...

HELENA

DHE ISMAIL KADARE

Nëse në pamje të parë ikona e letrave shqipe të krijon përshtypjen e një njeriu të ftohtë, duket se krejt ndryshe është ai me dashurinë e jetës së tij.

Në rrugët e Tiranës Helena dhe Ismail Kadare shihen gjithnjë dorë për dorë dhe mjaft të dashuruar.

Çifti janë shembull sa i përket ruajtjes së marrëdhënies së fortë mes tyre.



VENERA LUMANI

DHE LIND ISLAMI

Dashuria e tyre për muzikë solli edhe dashurinë për njëri-tjetrin. Venera Lumani dhe Lind Islami janë njohur gjatë spektaklit "The Voice of Albania", ku Venera u shpall fituese.

Jetojnë në Tiranë dhe vijnë të merren me muzikë, si dhe kanë realizuar bashkëpunime me njëri-tjetrin.



TIMO FLLOKO

DHE VERA GRABOCKA

Çift është mjaft energjik, i suksesshëm secili në profesionin e tij. Timo Flloko dhe Vera Grabocka janë të njohur jo vetëm për dashurinë e tyre, por edhe për arritjet e tyre profesionale.

Vera, producente e njohur, e Timo një nga aktorët më të mirë.



VESA LUMA DHE BIG BASTA

Nuk ishte muzika që i bashkoi çiftin e njohur Big Basta dhe Vesa Lumën, por vallëzimi. Ata u njohën më mirë me njëri-tjetrin gjatë pjesëmarrjes së tyre në spektaklin “Dancing With The Stars”, kur edhe u dashuruan.

Çifti e kanë kurorëzuar me martesë dashurinë e tyre dhe janë prindër të Lianit simpatik.

AMARDA TOSKA DHE ERMAL MAMAQI

Ami dhe Ermali janë dy nga personazhet e njohur shqiptarë, të cilët dashurinë e tyre të lindur në skenën e spektaklit “Portokalli” e kanë kurorëzuar prej vitesh me martesë.

“Mesazhi i parë që ia kam çuar Amit për kafe ka qenë gjatë mbledhjes së “Portokallisë”. Por, ajo nuk e kishte numrin tim dhe pyeti kush je...”

“Jam përballë teje, oj qorre!”, iu përgjigja.

Kështu, pra, ka nisur historia e tyre e dashurisë, e cila, nisur nga tipi i Ermalit, nuk mund të mungonin batuta të ndryshme. Pas një sërë programesh të realizuara bashkë dhe biznesit të tyre, tashmë Ami dhe Ermali janë edhe prindër të lumtur.



MIRIAM CANI DHE ALBAN SKËNDERAJ

Të dy këngëtarë, të dy mjaft të njohur dhe të dy shumë të dashuruar me njëri-tjetrin. Alban Skënderaj dhe Miriam Cani janë një nga çiftet më romantikë të shou-bizit. Ata kanë sjellë në jetë edhe dy fëmijë, që janë dashuria e tyre e madhe dhe motivi i jetës për ta.

N.

Këngëtares shqiptare që jetojnë në shtëpitë miliona dollarësh

Tashmë të kesh një talent dhe të dish ta shfrytëzosh atë, të bën personin më me fat në botë.

Edhe pse në ditët e sotme sa ujen dhe vështirësohet gjendja, mund të themi pa frikë se të jesh një këngëtare e mirë dhe të dish t'i bësh një reklamim të mirë vetes, e sidomos t'i gjesh njerëzit e duhur për të lidhur kontrata, të sigurohet njëherë e mirë jeta.

Dhe, jo vetëm kaq. Sepse, s'jemi duke folur vetëm për rastin e atyre që patën fatin të lindnin jashtë e të gjenin kontaktet e duhura për të qenë aty ku janë sot, por edhe këngëtarë të thjeshtë që nëpërmjet një koncerti të vogël përfitojnë mijëra euro.

Më poshtë japim listën e pasurisë së deklaruar dhe atë të llogaritur nga fitimet e një nate apo të shitjes së biletave të këngëtareve tona të famshme...

RITA ORA

Rita Ora renditet e njëmbëdhjeta në listën e muzikantëve më të pasur në Britani nën 30 vjeç. Dhe, me sa duket, po e përdor për të mirë pasurinë e fituar. Sipas gazetës "The Sun", këngëtarja u bleu shtëpi prindërve në Prishtinë gjatë vitit që shkoi. Pamjen e vilës nga jashtë e publikoi nëna e Ritës, Vera, me një përshkrim mbi rëndësinë e një shtëpie në qytetin e lindjes.

Vila ndodhet pak minuta larg qendrës së Prishtinës, në një kompleks luksoz vilash në "Bërnica Park". Sipas "The Sun" pronë ka kushtuar 1.5 milionë paund anglez. Prindërit e Rita Orës u larguan nga Prishtina në vitin 1991 për në Angli. Prindërit e Ritës kanë kontribuar gjatë gjithë jetës në suksesin e saj dhe dëshira më e madhe e këngëtares ishte t'u dhurojë diçka që të jetojnë mirë.



BEBE REXHA

Këngëtarja shqiptare, Bebe Rexha, ka vilë madhështore 2 milionë dollarësh në "Hollywood Hills". Ylli e bleu shtëpinë në vitin 2018, e cila ka një ndërthurje të stilit francez dhe italian.

Beben e karakterizon mikpritja, një ndër vetitë daluese të sjelljes shqiptare, pasi ajo që bie në sy është se në shtëpinë e saj, veç luksit të madh, ka edhe dy dhoma gjumi për miq.

DUA LIPA

Këngëtarja e famshme, Dua Lipa, e ka bërë botën për vete me këngët e saj “New Rules” dhe “IDGAF” dhe bashkëpunimi i saj më i fundit me DJ-in skocez, i titulluar “One Kiss”, pritet të jetë hiti i radhës.

Si ka hyrë këngëtarja e famshme në skenën muzikore?

Këngëtarja dhe tekst-shkruesja shënoi sukses të madh pas lansimit të albumit të saj të fundit.

Londinezja është e lindur në Kosovë, ndërsa prindërit e saj kanë emigruar në Angli në vitet 90 dhe janë rikthyer në Kosovë në vitin 2008.

Kur ajo ishte 15 vjeçe u rikthye në Mbretërinë e Bashkuar me shpresë që të bëhet këngëtare. Lipa ka qenë rregullisht në top-lista që nga viti 2015, por ka postuar “covers”-a në kanalën e saj në “YouTube” qëkur ishte 14 vjeçe.

Këngëtarja vlerësohet të ketë pasuri rreth 3 milionë dollarë. E ka arritur këtë pasuri nga shitjet rekorde, turnetë dhe duke punuar si modele.




BLEONA QERETI

Bleona Qereti e “tronditi” opinionin publik me pasurinë e saj 15 milionë dollarë. Deklarimi i pasurisë së Bleonës është publikuar nga disa portale online, ku, mes të tjerash, bëhet shkurtimisht një përmbledhje e karrierës së saj.

Të gjithë pohojnë se shifra e deklaruar nga Bleona është e fryrë, jo e vërtetë.

Pamela Aliaj

A portrait of a woman with long, straight, light-brown hair, wearing a white, off-the-shoulder, textured knit top and a pearl necklace. She is looking directly at the camera with a neutral expression. The background is a soft, out-of-focus mix of red and blue light.

Linda, e sukseshmja e fushës së bukurisë që nuk ndalet

Lindita Iseni Emerllahu, për të gjithë e njohur si Linda, është femër e sukseshme, e cila ia ka dalë fuqishëm si grua, nënë dhe profesioniste tashmë e dëshmuar.

Linda njihet për punën e shkëlqyer që bën në fushën e parukerisë, për markën e saj të flokëve “Linda hair extensions” dhe shërbimet ekskluzive estetike që ofron në sallonin e saj “Linda coiffure et esthétique”. Linda jeton në Gjenevë të Zvicrës. Është grua e suksesshme në biznes. E do shumë profesionin e saj dhe konsiderohet eksperte e ngjyrave. Në Gjenevë është tejet e kërkuar për ngjyrat bionde, meqë e ka edhe markën e saj të flokëve extensions që quhet “Linda hair extensions”.

LINDA ME 20 DIPLOMA

Linda u bë tejet e njohur kur tregoi publikisht se i ka 20 diploma dhe certifikata, e fundit për laser, me të cilin edhe punon në sallonin e saj.

Kjo pajisje e fjalës së fundit të teknologjisë shërben për heqjen e qimeve pa djegie apo dhimbje. Ndërkohë, në sallonin e njohur të Lindës vazhdon të punohet me flokë, thonj, pedikyr, manikyr, depilime, pastrim të fytyrës, mbjelljen e qerpikëve etj.

Pa dyshim, asaj i pëlqen më së shumti kur bën transformime të mahnitshme në flokë, të cilat mund t'i shihni edhe në faqen e saj në “Instagram”.

Te Linda ofrohet gjithçka që ka të bëjë me flokun, si: prerje, fenerim, shatir, ombre, frizura, minivall, drejtim të flokëve për 6 muaj etj.

Pastaj, pedikyr, manikyr, mbjelljen e qerpikëve, pastrim fytyre, tatuazhe të vetullave, depilim etj. Risi janë produktet e frizerit me famë botërore, Mounir, që tashmë janë në Gjenevë dhe për herë të parë në sallonin “Linda coiffure et esthétique”.

Linda na tregon se tashmë ka nisur të mbajë edhe trajnime profesionale dhe se secili kandidat, në fund, pajiset me certifikatë.

Imazhin e “Boom”-it e pyetën se cila është formula e suksesit që ia del kaq mirë dhe ajo na tha prerazi se është vetëbesimi, vullneti, por edhe përkrahja e madhe e familjes dhe e bashkëshortit, përkrahje kjo që nuk i ka munguar asnjëherë.

N. Neziri





Tolgahan Sayisman (“Çenari”) tregon prapaskenat e serialeve turke

A është gjithçka që shohim në një serial e vërtetë? Me siguri, shumë prej jush ia kanë bërë këtë pyetje vetes... Ja çfarë tregon Tolgahan Sayisman, protagonist i serialit “Mos u dorëzo”, e për publikun në Kosovë i njohur me rolin e “Çenarit”, por edhe si burri i modeles dhe aktore shqiptare Almeda Abazi...

Shqiptarët janë shumë kureshtarë për seriale turke me tematikë të ditëve të sotme. A jetohet, vërtet, bukur në Turqi? A janë të vërteta shtëpitë e bukura dhe marrëdhëniet që krijohen në familje?

- Turqia është shtet kozmopolit, shumë i madh. Këtu jetojnë 80 milionë banorë dhe është e vështirë të jesh mes kulturave të ndryshme.

Republika e Turqisë është formuar nga grupimi i njerëzve me etni të ndryshme, një lloj ekstrakti i shtetit osman. Meqë shpesh ndodh që njerëz me kultura të ndryshme janë të detyruar të jetojnë në të njëjtin vend, mund të dalin në pah sjellje dhe marrëdhënie të ndryshme. Për këtë shkak edhe televizionet turke nuk i lënë shumë vend imagjinatës, por huazojnë gjëra që janë parë e janë dëgjuar në Turqi, gjëra që u kanë ndodhur njerëzve, qoftë lidhje familjare, qoftë marrëdhënie pune.

Pra, pak a shumë janë gjëra që tregojnë jetën në Turqi. Megjithatë, për hir të skenarit, sajohen edhe situata që nuk kanë ndodhur.

Sigurisht, një rëndësi të madhe ka edhe aspekti ekonomik. Jeta e njerëzve të pasur dhe ajo e njerëzve të varfër që shihni në përgjithësi në seriale është e vërtetë, sepse edhe xhirimet bëhen në shtëpi të banuara në Turqi.

Pra, ato që i shihni janë të vërteta...



Sa kohë xhironi për një seri?

- Në fillim zgjaste më shumë, por më pas e mbaronim për gjashtë ditë.

Sa punon që producentët të të zgjedhin si aktorin kryesor, sepse rolet tua kanë qenë si aktor kryesor?

- Kjo është diçka që ndryshon në varësi të situatës. Lidhet ngushtë me faktin se sa i vështirë është interpretimi i një personazhi. Varet edhe nga ajo që mund t'i ofrojë personazhi skenarit.

Në Turqi, zakonisht, në seriale personazhi ndryshon vazhdimisht edhe pas ndërtimit fillestar të karakterit. Ndonjëherë ndodh që duhet një vit për një personazh, ndonjëherë më pak se një muaj.

Mua më mjaftojnë një ose dy muaj për ta krijuar plotësisht një personazh. Kjo është shumë e rëndësishme. Në Hollywood kjo periudhë varion nga një deri në dy vjet.

“Boom”



Boat Trip

Don't forget this summer!



 /canyonmatka_

TEL: +38970726265



Gruan e kam të ndershme, por vetë jam budallë!

Gruan e kam të ndershme, por nuk ka aspak bukuri. Ka vite që nuk e kam prek me dorë, sepse nuk po më tërheqë...

Jam 40-vjeçar, i martuar. Më martuan familja. Pranova të jetoj me gruan që ma sollën në shtëpi. Dhe, me të i lindëm dy fëmijët që i kemi. Gruan e kam të ndershme, punëtore, por nuk është e bukur. S'ka bukuri.

KA VITE QË NUK FLE ME GRUAN!

Andaj, ka vite që nuk fle me gruan, nuk kemi intimitet. Neveritem kur më ofrohet. Gjej ndonjë justifikim dhe kaloj të fle në dhomën e fëmijëve. Kam kërkuar nga ajo të ndahemi, por ia nisë të qajë dhe çdo fjalë tonën e kalon te fëmijët, ndaj të cilëve më duhet të aktroj sikur e dua shumë nënën e tyre...

Sidoqoftë, para një viti u njoha me një vajzë nga Shqipëria, konkretisht nga Shëngjini, ku edhe kam shkuar shumë herë. Është shumë e bukur, e dashur. Krejt ndryshe nga gruaja ime.

Dhe, që nga njohja me të ndihesha sikur jetoja prapë, e jo si deri atëherë... U bëra plotësisht njeri tjetër...

DUA TË DIVORCOHEM NGA GRUAJA, POR KAM FRIKË...

Tani dua të divorcohem dhe ta marrë grua vajzën që e dashuroj, por kam frikë. Kam frikë se si do të ndjehen fëmijët dhe familjarët, sepse e dua shumë gruan time, ani pse për mua

nuk zgjon kureshtje. Pra, të gjithë e duan, e vetëm unë jo!

Por, edhe nga dashnorja nuk mund të ndahem, sepse jam dashuruar marrëzisht. Është femra më e mirë që kam takuar dhe e dua jashtëzakonisht shumë. Kemi dashuri të sinqertë, m'i lexon edhe mendimet, edhe lëvizjen e buzëve...

Andaj, dua të marrë një vendim dhe të vendosi njëherë e përgjithmonë për të ardhmen time, sepse kështu jeta nuk po shkuaka dhe qenka jashtëzakonisht vështirë të jetosh me dikë që nuk e dashuron...

A ka kush t'më këshilloj se si të veproj, sepse edhe po të kesh miliona nuk po vlejtkan kur nuk ke rehati shpirtërore?

F. F., Ferizaj



Shkencë. Etikë. Art.

FYTYRA & QAFA

- Operimi i Hundës (Rhinoplasty)
- Operimi i Qepallës
- Operimi i Veshit (Otoplasty)
- Ngritja e Vetullave
- Ngritja e Qafës
- Korigjimi i buzës së çarë, hundës dhe qiellzës së butë
- Korigjim i Nofullës
- Ngritja e Fytyrës - Facelift

GJOKSI

- Zmadhimi i Gjirit - me implante MENTOR
- Ngritja e Gjinjëve
- Zvogëlimi i Gjirit
- Zvogëlimi i Gjirit tek Meshkujt

OBESITETI

- Baloni Gastrik - Spatz[®]
- Gastric sleeve
- Dietë e personalizuar

TRUPI

- Abdominoplastika
- Liposuction
- Formimi i trupit me definim të lartë
- Ngritje Krahu (brachioplasty)
- Ngritja e kofshes
- Ngritja e mollaqit - vitheve
- Rritja e mollaqit - vitheve
- Labioplastika - vaginoplastika
- Aplikimi i expanderëve - zmadhuesve

PROCEDUARA MINORE

- Heqja e Moleve / Nishanëve
- Heqja e Tatuazheve dhe Mbresave

MBJELLJA E FLOKËVE

- Mbjellja e flokëve
- Mbjellja e mjekrës
- Mbjellja e vetullave

EKIPI NDËRKOMBËTAR NË BASHKËPUNIM ME EKIPIN VENDOR I JAPIN KUPTIM TË BUKURËS



DR. SELAHATTIN
ÖZMEN



DR. NEDŽAD
RUSTEMPAŠIĆ



DR. GUIDO
MARONATI



DR. IVO
DŽEPINA



DR. ŞÜKRÜ
YAZAR



DR. NECDET
UÇAR



DR. YUNUS
YAVUZ

E adhuruara...

Si e gjet Poni burrin me kokallë?

Muzikën e saj e njohim të gjithë, por dimë shumë pak për jetën personale të saj. Pse?

Këngëtarja e mirënjohur Poni ka qenë gjithmonë hermetike në lidhje me jetën e saj jashtë skenës, ndërsa ka preferuar ta mbajë larg vëmendjes së publikut partnerin e saj vlonjat, si dhe djalin e tyre të vogël.

Pse?

“Mendoj se çdo gjë është e shkruar. Kur kam qenë e re mendoja se nuk do të merrja kurrë një burrë nga Vlora, sepse me natyrën që kam, atë


5 minutën, nuk do më duronte njeri. Intuita më la në baltë dhe shkova aty ku e kishte shkruar Zoti, gjeta një vlonjat tolerant, i vetmi që ishte dhe e mora unë”, u shpreh këngëtarja ditë më parë.

Sidoqoftë, Poni është këngëtare e njohur dhe autore këngësh. Emri i saj është Shqiponja, e lindur më 8 nëntor 1981, e martuar dhe me një djalë.

Poni është emri i saj i vegjëlisë, të cilin edhe e zgjodhi njëkohësisht si emër artistik.

Por, krahas muzikës dhe shkollimit për muzikë, Poni diplomoi në Shkencat Politike.

Ka 7 albume dhe qindra koncerte brenda dhe jashtë vendit, si në Amerikë, Australi, Itali, Greqi, Gjermani, Francë, Norvegji etj., si dhe shumë çmime.






★★★★★
BREZOVICA
HOTEL & SPA



PREMIUM SUITE

1 Queen Bed
Private Jacuzzi in balcony



DELUXE SUITE

1 Queen size bed & sofa
1 King Bed
Jacuzzi & fireplace



*Hotel for
every type of vacation*

sales@brezovicahotel.com or call +383 49 30 10 30
www.brezovicahotel.com



Cilat janë "foret" e vajzave që ikin?

Femrat e ikura, shumica e të cilave janë ende të mitura, nuk ikin prej askujt, por shkojnë dhe kënaqen me shoqëri. Nuk po prejudikojmë me kë dhe me çfarë shoqërie, por, në shumicën e rasteve, ato i shtynë dashuria dhe motivi për më shumë liri...

SI IKIN NGA SHTËPITË VAJZAT DHE FËMIJËT E LËMOSHËS?

Në Kosovë që nga paslufta e këndeji kemi dëgjuar për shumë raste të paraqitjes së prindërve në polici për "zhdukjen" e vajzave të tyre.

Në dukje të parë kjo dukuri është shqetësuese dhe alarmante. Por, edhe policia janë mësuar me foret e tyre, e të cilat kanë qëllim kënaqësie e dashurie...

"Hajt bre se të kthehet vajza, hiç mos u tutë!", i thotë shoku-shokut, në ditën që ai i tregon se i ishte larguar vajza pa asnjë paralajmërim.

"Pjesa dërmuese e atyre që "zhduken" kthehen vetë në shtëpitë e tyre, por si-

kur harrojnë se demokracia nuk do të thotë edhe të bësh ç'të duash", thotë Mensur Veli, student i sociologjisë.

FJALA E EKSPERTIT...

Sociologët e elaborojnë këtë problem si aspekt të papërgjegjshësisë në raportet prind-fëmijë. Reperkusionet tjera, sipas tyre, i përkasin natyrës së varfërisë së skajshme dhe shtrëngimit të tepruar të tyre nga familja.

"Ka femër e cila mbahet e mbyllur si në kafaz! Dhe, kur zogut i hapet dera, ai më nuk kthehet aty ku ka qenë, apo kthehet vetëm pasi të ketë përmbushur nevojën shpirtërore të plotësimit të dëshirave dhe emocioneve", thotë studenti i sociologjisë, Mensur Veli.

Dhe, ky është komenti më i thjeshtë i ekspertit, i cili, megjithatë, thekson se prindërit janë ata që më së shumti brengosen...

Ç'MUND TË PËRFUNDOJMË?

Kosova dhe Shqipëria, si shoqëri sociale, një shumicë e të cilëve jetojnë në varfëri të skajshme, paraqesin rastin më të nxehtë i ikjes së vajzave nga shtëpitë e tyre.

Por, kjo dukuri i prekë edhe të gjitha shoqëritë etnike në tranzicion. Madje, disa vajza fillojnë me shëtitje e kalojnë në prostitucion, e ky është problemi i dytë i njohësve të shoqërisë civile. Pra, keq e më keq...

Diturie Haxhaj

nPeshk

TERRACE



Kontakti:
045/840-850
045/233-211

Këngëtalet tona që u martuan në adoleshencë

Ato tashmë janë shumë të njohura. Kanë karrierë të bujshme muzikore. Pos fillimeve të hershme me këngën, disa nga këngëtalet tona kanë filluar herët edhe jetën bashkëshortore. Madje, në moshë shumë të re janë bërë edhe nëna. Cilat janë disa prej tyre?



GJYSTE VULAJ

Këngëtarja Gjyste Vulaj është njohur me bashkëshortin e saj, Sokolin, që në moshën 15 vjeçe, ndërsa në moshën 16 vjeçe është martuar. Këngëtarja nga Malësia e Madhe, si 20-vjeçare, solli në jetë fëmijën e parë, Rozanën, kurse pas afro 20 vjet martesë, vjen në jetë edhe djali, Besarti. Dhe, pavarësisht "gojëligëve" që flasin mbi jetën e saj personale dhe bashkëshortore, duket se vetëm sa ia shtuan dashurinë e madhe që ka për burrin, Sokolin.

ALBËRIE HADËRGJONAJ

Ndonëse është nënë e dy vajzave, këngëtarja Albërie Hadërgjonaj nuk është bërë nuse asnjëherë. Këngëtarja deçanase është bërë nënë në moshën 16 vjeçe. Si gjimnaziste në Deçan ajo u njoh me Mentorin. Ishte vetëm 15 vjeçe, ndërkohë situata e vështirë që kishte filluar në vitet 80 në Kosovë bëri që ajo, bashkë me Mentorin dhe familjen e tij, të shpërngulen për në Amerikë. Pas vetëm një viti, pra në moshën 16 vjeçe, Albëria bëhet nënë, duke sjellë në jetë vajzën e madhe, Agnesën. Pas dy viteve në Amerikë lind edhe vajza tjetër, Anxhelina, e cila tashmë është e njohur edhe si këngëtare. "Nuk u martova asnjëherë. Regjimi i Milosheviqit s'më la ta gëzoja jetën siç duhej ta gëzonte një adoleshente. Mbetëm me trasta në krahë, sa në Kosovë e sa në Amerikë dhe nuk patëm mundësi të bënim dasmë", ka thënë këngëtarja Hadërgjonaj.



ELI FARA

Ka mbetur "single" që në kohën kur u nda nga bashkëshorti, Luli Kapurani, të parin mashkull që kishte njohur e që u bë babai i vajzës së saj të vetme, Marinës. Eli Fara vazhdon të mbetet një ndër ikonat e bukurisë, sharmante dhe e ëmbël, edhe pse po u ofrohet të 60-ave. Këngëtarja korçare u njoh me ish-bashkëshortin e saj që në moshë të re. Filloi të bashkëjetojë me të ende pa i mbushur 17 vjet. Ndërkohë, u bë edhe nënë. Në moshën 20 vjeçe Eli u nda nga bashkëshorti, duke e rritur vajzën pa praninë e babait. Çifti në atë kohë u ndanë, ngase kishte ndodhur një sherr midis grupeve, ku pati edhe një vrasje. Pas divorcit dhe burgosjes së ish-burrit, Elit iu desh të shpërngulet për të jetuar në Amerikë. Më pas ajo kthehet sërish në Shqipëri për të vazhduar aktivitetet e saj muzikore. Këngëtarja Fara këshillon se martesë në moshë të re është një gabim shumë i madh. "Nuk e konsideroj gjë të mirë faktin që jam martuar në moshë shumë të re, që kam lindur fëmijën kaq herët", ka këshilluar ajo.

A.



Detajet bëjnë diferencën.



[f](#) [@](#) [globe](#) www.cimaks.com



...e ku ka më mirë se në Vendlindje!



Kompleksi Te Kodra - Suharekë

[f](#) [@](#) [globe](#) www.cimaks.com



E la burrin në spital, e vetë tarahenet nëpër motele!

Burrin e kam quar në spital. E bëra një të dashur tjetër, por më vjen marre që jam femër...

Në moshë të re e lashë vendlindjen. Mora rrugën e kurbetit bashkë me bashkëshortin tim. Pas një kohe morëm lejeqëndrim. Në atë kohë i kisha tre fëmijë dhe kisha jetë të lumtur. Por, pas 13 vjetësh martesë ndodhi ajo që nuk e kisha pritur kurrë. Jeta dhe lumturia ime u fundosë. Burri filloi të ketë probleme psikike. Filluan problemet, maltretimet. U mundova një vit ta ruaj familjen që të mos shkatërrohet, por ishte e pamundur. Burri u shtri në spital, e unë e vazhdova jetën me fëmijët e mi...

Dhe, fal Zotit u rritën e u shkolluan, e edhe u martuan. Andaj, jam krenare me sukseset e tyre...

SI RASHË NË GRACKËN E NJË BURRI MASHTRUET NGA KOSOVA?

Megjithatë, para një viti u njoha me një person. Në fillim dukej shumë burrë i mirë. Andaj, vendosa t'ia jap një shans vetes, por edhe atij, sepse edhe ai kishte pasur një martesë të dështuar.

Ai jetonte në Kosovë e unë jashtë Kosovës. Komunikimin e bënim nëpërmjet telefonit, madje me orë të tëra.

E, kur erdhi koha e pushimeve verore, u takuam dhe vendosem ta kalojmë pushimin bashkë. Dy ditët e para i kaluam shumë mirë. Por, e vëreja se tipi nuk e përdorte telefonin. Pashë se e kishte fikur!

Dhe, fillova të dyshoj se po fshehte diçka prej meje...

Në një moment rastësisht e hapi telefonin dhe harroi ta fikte. E hapa. Dhe, çka të shihje – numra me emra femrash sa të duash! Sidoqoftë, me gjakftohësi u përmbajta dhe nuk i thashë gjë, edhe pse u lëndova në shpirt.

PSE TURPËROHEM PËR ATË QË BËRA?

Dhe, kur u ktheva në Zvicër, në "Facebook" e hapa një fajll të ri, me emër tjetër. Dhe, fillova t'i shkruaj...

Më tha "Hyre në grupin tim!". E, kur hyra, as tash s'mund të besoj se sa femra kishte qenë në atë grup... Aty pashë femra degjeneruese...

Andaj, turpërohem që edhe unë u gjenda aty. Turpërohem që isha pjesë e atij grupi...

Fidaime E., Zvicër



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritëse që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksesit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?!

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbërë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degjenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjezik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurrja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjavin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qulllet trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



A ka në Kosovë “derra të lumtur”?

Është riaktualizuar Dik Marti. Kësaj radhe kokën e tij e kërkon Edi Rama. Jo për t’ia vënë kokën në litar, por për ta degraduar fytyrën e shitur të ish-senatorit zviceran.

Ditët e pasluftës për shumë kënd kanë qenë më të këqija sesa ato të para luftës. Dikur, para vitit 1999, ishte një rrezik që Serbia t’i vriste shkencëtarët në Kosovë, nën vulën e politikës.

Megjithatë, në këtë të keqe ishte një e mirë: Vrasjet politike kishin një të mirë pas vetes, sepse krijonin histori e historia krijonte emra dëshmorësh.

E, ÇKA PAS LUFTËS?

U dënua profesori dhe urologu më në zë i Kosovës dhe më gjerë, Lutfi Dervishi me të bijtë. Njeriu që i shërbeu një karrierë jetësore qytetarit të Kosovës me dhe pa para, njeriu që për nga aftësitë kirurgjikale ishte mbret i këtij zanati në Kosovë.

Dhe, nuk është vetëm një e keqe se ai u dënua! Një e keqe më e madhe është se dënimit të tij nga EULEX-i i ka fryrë Serbia dhe Dik Marti zviceran nga Parlamenti Evropian, duke akuzuar shqiptarët për veshkat serbe në Tropojë të Shqipërisë, madje duke i dhënë edhe emër asaj shtëpie që tashmë është e njohur si “Shtëpia e verdhë”!

Ndonëse Lutfi Dervishi zotëronte zanatin për një mjekësi të tillë kirurgjikale, ai ra viktimë e këtij zjarri që fryu nga Beogradi dhe qendrat tjera pansllaviste, por edhe të atyre që lidhen me simpa-

titë sllave dhe teoritë.

Mori dënimin Lutfi Dervishi më shumë falë zhurmës që lansoi Beogradi dhe Dik Marti, meqë ata donin ta lidhnin “Medikusin” me Tropojën. Ndonëse nuk është thënë zyrtarisht kjo gjë, drejtësia e këtij rasti u vu nën prangat e politikës antishqiptare për t’u kualifikuar këto transplantime me “Shtëpinë e Verdhë” në Shqipëri, ku gjoja ishin hequr veshkat e serbëve për t’u trafikuar për qëllime mjekësore. Ata që lansuan këtë tezë e dinë se kanë lansuar një rrenë. E, ata që dënuan e dinë, gjithashtu, se ky rast nuk ka lidhje me Tropojën, por zjarrit i frynë Serbia dhe Dik Marti, me të cilin ditëve të fundit u befaskan gjyqtarët dhe zyrtarët juridikë që ngritën këtë rast. E, ai që kishte premtuar se do të vinte me kënaqësi t’i prezantonte dëshmitë e veta në Prishtinë nuk erdhi!

A do të kishte ardhur sikur të kishte pasur çfarë të thoshte?

Me siguri, po.

E, pse, pra, nuk erdhi Dik Marti?!

Sepse, nuk kishte çfarë të argumentonte!

Kirurgu Lutfi Dervishi mori dënimin me tetë vjet burg dhe nuk po e komentojmë dënimin e as akuzën sa ka pasur e sa nuk ka pasur të drejtë të kryejë operime të tilla në Kosovë. Megjithatë, përtej kësaj qëndron diçka që e shprehë populli ynë, qytetari i Kosovës, se Lutfi Dervishi paskësh qenë për çmimin "Nobel", meqë paskësh pasur aftësi të tilla urologjike!

Pra, nuk e paskemi ditur se paskemi pasur një kirurg të tillë, më aftësi të jashtëzakonshme, sepse ne jemi mësuar vazhdimisht t'i lavdërojmë vetëm mjekët serbë, maqedonasit dhe të tjerët për aftësi, e mjekët më të aftë i paskemi pasur në Kosovë... Sidoqoftë, ekziston edhe një bindje tjetër në popull për Lutfi Dervishin: Ai nuk do të dënohej dhe as që do të krijohej një dramë për të sikur të mos vinte zjarri nga Beogradi...

BËRTIT

"KOSOVA-REPUBLIKË"

DHE DO TË SHPËTOSH!

Por, ka edhe më keq! Lexova rrëfimin të një nëne, e që është bërë nënë për të tretën herë...

Vetëm pak rrëfime të luftës, që janë përshkuar me masakrime, më kanë rrëqethur më shumë se ai rrëfim. Dhe, para vetes më del një ngjarje tmerr, në të cilin sheh menjëherë se ku është drejtësia, ku është mjekësia, ku është përgjegjësia e mjekut e infermieres...

Sheh se nuk jemi në shtet moral dhe ligjor, sheh se nuk jemi askund hiq! Thuajse mjekun e asaj nate, e që ishte kujdestar, e kishin kidnapuar!

Fitohet përshtypja se po të kishte pak nuanca politike ai rast, do të reagonin edhe nga qeveria, edhe nga tërë bota...

E mira e vetme është se ajo nënë ka lindur dhe ka shpëtuar, por e ka parë vdekjen me sy derisa e ka kaluar atë gjendje që i ka prodhuar trauma dhe me tërë arsyen po them se dikush duhet të shkojë në përgjegjësi, e kush dihet...

Kujdestarët e asaj nate duhet të përgjigjen penalisht për rrezikim jete të një pacienteje që mezi ka shpëtuar falë Zotit.

E thamë se ka edhe më keq për faktin se dikush mund t'i merr tetë vjet burg, si doktor Lutfi Dervishi për veprën që nuk e ka bërë, e dikush nuk dënohet fare, edhe pse ka bazë për dënim!

Çka është dashur të bënte ajo nënë që të mos i kalojë tërë ato probleme dhe trauma?

Këtë po e ilustruj me një batutë: Kishte rënë një njeri në ujë dhe, meqë nuk dinte not, i shtrohet rrezikut të vdiste. Dhe, teksa i rrezi kuari kërkonte shpëtim, nga bregu e shikonte një njeri që nuk dinte not.

Dhe, ai, kur e pa që po fundosej, i tha:

"O jaran, unë nuk di not, por nëse do të shpëtosh bërtit të madhe "Kosova-republikë" dhe të nxjerrin!"

E, fill pas britmës "Kosova-republikë", posa e dëgjuan policët, e nxorën dhe e quan në burg.

E, çka duhet të bërtasin pacientët tanë që të shpëtojnë nga vdekja? Nuk di, ndoshta do të ishte mirë të kërkohet diçka e madhe, por më nuk ka gjëra të mëdha politike. Me cilin adresim politik të llojit të parullës mund të shpëtosh sot veten?

Më së miri do të ishte që nëse shkon në spital duhet t'i kesh në xhep nja 500 euro e t'i japësh "për një kafe"!

BUNA E DO BABANË VEÇ NËPËRMJET TELEFONIT!

Por, ka edhe më keq! E, ai është kurbeti! Buna, dyvjeçare, mendon se me babin e saj duhet të flas në

telefon dhe ta sheh dy apo tri herë në vit...

Pra, mbesa ime, Buna, kështu është mësuar ta dojë babin e vet që është prej kohësh në kurbetin e llojit shqiptar, kur s'ka zgjidhje tjetër dhe kur nuk ka më mirë bën edhe kështu. Ose: "Kur s'ka shi bën edhe breshër"! Ajo, kur i vjen babi nga jashtë nuk di të gëzohet, sepse mendon se dashuria ndaj prindit vjen nga zëri i telefonit. E, ne jemi mësuar të shohim ëndrra të këqija, për ndryshim nga evropianët, të cilët dinë të shohin më shumë ëndrra të mira sesa të liga. Ata janë mësuar të jetojnë mirë dhe, normalisht, ëndrra, si pjesë psikologjike e të jetuarit, zakonisht sillet aty qysh është jeta. Të varfër kemi qenë. Me bishta po, sharraxhi po, argatë po, siç thotë edhe Esad Mekuli në një poezi të tij.

Por, solidarë kemi qenë gjithmonë...

VAJZA E LIPJANIT MORI BURRË SLOVAKUN!

Slovaku është shtetas i shtetit që nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës.

"Po, si e gjete një të tillë, që nuk na e njeh as shtetin?!", i kishte thënë babai.

E, ajo ia kthen: "Lëre ai që nuk e njeh Kosovën, por as unë!".

Pra, paska keq e më keq! Dhe, teksa kalonte një shkrimtar panë nesh, ku edhe pinim kafenë e mëngjesit, pamja e tij gjatë ecjes më jepte të kuptoj se ai ka luajtur...

Teksa ecë më shumë e mbanë kokën lart, herë-herë e kthen anash e pas dhe sikur nuk di as vetë se për ku është nisur...

E, për të gjetur atë që do dhe atë që nuk do, mbase edhe duhet të jesh i krisur, apo sikur thoshte Noli "Derr i lumtur"!

Pra, edhe kjo është keq!

Sokol Murturi

Ku me gjet një njeri që më merr për grua?

Jam e re, e bukur, me krejt të mirat, por askush nuk më merr për nuse, edhe pse i kam vetëm 26 vjet. Më duket se dikush më ka bërë sehire...

Kam qenë në lidhje dashurie me një djalë dhe isha shumë e lumtur. Ishim afër fejesës, por në moment ndërroi gjithçka dhe ai u fejua me një tjetër, e mua më la. Dhe, kam vuajtur shumë derisa e kam harruar. Megjithatë, ende më rri në zemër dhe e kujtoj...

HALLA MA PRISHI FEJESËN!

Por, t'i kthehem edhe një herë të kaluarës sime. Para se me u njoftua me të kam qenë te një grua me ma ka shikuar filxhanin e kafes. Më tha ke me u njohë me dikë, por në atë familje është një person që të njeh dhe ruajta prej tij... Mendoj se halla ime ishte ajo, meqë edhe jeton në atë familje. Shpesh kem pasur konflikt me të për sene banale... Dhe, ne jse... Problemi që e kam tash është se prej atëherë jam munduar me e njohtë dikë tjetër, por nuk po kam sukses. Në fillim, kur njihem me dikë, puna ecë mirë, por shpejt prishet! Secili më thotë se nuk

është i gatshëm për lidhje serioze. Kështu më ndodhi edhe gjatë verës që shkoi. U njoha me një djalë dhe u dashurova në të që në shikim të parë. Njohja me të erdhi pasi ma sugjeruan familja, e që e njihnin që moti... Edhe këtë herë fillimi ishte i mirë, por shpejt u ftohë prej meje dhe më tha, si të tjerët, se nuk është i gatshëm për lidhje serioze. Konkretisht, më tha: "Je shumë e mirë. E meriton një më të mirë se unë!".

NUK PO MË DEL NAFKA, JAM NË SIKLET TË MADH!

Tash, pas gjithë atyre djemve që i njoha, më ka kapur një siklet i madh: Nuk po më del nafaka, çka të bëj?! Si me e gjet një person që më merr për grua? Andaj, jam në siklet të madh... Sepse, edhe pse e re, nuk po e gjej askënd me u martua, me krijua familje, me u stabilizua në jetë... Shkurt e shqip: Dikush më ka bërë sehire dhe po më pengon të marthohem...

Ajmanja, Deçan



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Duhemi, por nuk mund të martohemi!

Jam 31-vjeçare, në lidhje me një person me të cilin duhemi shumë, por martesë jonë nuk është e mundur. Ai po kërkon prej meje që të refuzojë çdo ofertë për fejesë, sepse ka dëshirë të vendosë me mua, por unë nuk dua të pranojë një martesë të tillë, edhe pse nuk mund të mësohem pa të apo duke e pasur dikë tjetër. Çka të bëj, motër e dashur?

“Ne, të dy”

Përgjigje:

Ai është person i martuar dhe i ka dy fëmijë. Pa marrë parasysh dashurinë tuaj, ai ka grua, të cilën e ka marrë me shumë dëshirë dhe është për ta ruajtur.

Kur të keni parasysh rrethanat mes jush dhe gjërat që ju rrethojnë, ti nuk ke asnjë arsye ta presësh tutje një burrë të martuar, i cili veç është në proces të mbylljes së kompletimit të familjes.

Pra, nuk është korrekte që ti ta humbësh perspektivën dhe jetën duke e pritur një burrë prej të cilit nuk pritët të kesh asgjë.

Nëse lidhja juaj zgjat ende dhe nëse vendosë ta presësh atë sipas sugjerimit të tij, atëherë parashikoj që ai të hapë probleme me familjen e gruas, me familjen e vet dhe me gruan.

Andaj, tërhiqur dhe gjeje fatin tënd,

sepse nuk është vetëm ai mashkull në botë!

Pse burri nuk ka ndjenja ndaj meje?

Jam grua, 36-vjeçare. Kam fëmijë dhe jetoj jashtë vendit. Ka kohë që burri nuk ka ndjenja për mua. Jam munduar në shumë aspekte ta ofrojë pranë vetes, duke e ringjallur nga ana emocionale, por kot.

Kemi biseduar herë pas herë për këtë problem dhe nuk e di arsyen pse ka ardhur te kjo situatë. Më është bërë bajat jeta me të dhe nuk di çka të bëj tutje... Kështu nuk jetohet, por çka të bëj, zonjë e nderuar?

“E brengosura”

Përgjigje:

Para së gjithash, duhet të dihet e vërteta pse ka ndodhur ky defekt. Nëse ndryshimi ka ndodhur për shkaqe shëndetësore, ti duhet ta pranosh jetën e tillë si bashkëshorte e tij besnike. E, nëse ndryshimi te burri ka ndodhur për shkakun e aventurave të tij, e drejta jote për të zgjedhur një mënyrë jete që të përshtatet është legjitime. Ky është një standard parimor i përafërt edhe me kodin popullor edhe me atë shkencor e social, por çka shoh unë te ju është pyetja që ma keni adresuar mua... Unë shoh se ju asnjëri nuk keni

jetuar besnikërisht në bashkëshortësi. As ti nuk je në nivelin e ndjenjave për burrin e as ai për ty. Ky është treguesi më i saktë i gjendjes suaj. Nuk duhet ta prishni bashkëshortësinë, meqë asnjëri nuk jeni në rregull.

Ai e ka hetuar gjendjen tënde dhe ka ndryshuar negativisht me ndjenjën ndaj teje, prandaj duhet të bashkëbisedoni dhe ta harroni të kaluarën e afërt që ju ka bezdisur në deharmonizimin bashkëshortor.

Pse vëllai nuk bisedon me askënd në shtëpi?

Jam vajzë, 28-vjeçare, nga Gjakova. Ka një vit që frikësohem shumë e nuk ndjem rehat askund dhe me asgjë. Nuk di çka po ndodh me mua!

E kam kryer fakultetin, por nuk ma merr mendja të punësohem, meqë nuk kam koncentrim. Gjithashtu, vëllai im e ka kryer fakultetin, por është mbyllur shumë në vete.

Jetojmë me një rrogë dhe nuk jemi mirë, por mundohemi t'ia dalim. Më duket se po mëkatojmë me babanë, i cili na thoshte se mezi po pres ta mbaroni fakultetin dhe të punësoheni dhe të më ndihmoni...

Të lutem, çka po ndodhë me ne? A kemi magji apo çka është në pyetje?

“E bukura”

Përgjigje:

Në rrethanat tuaja sikur po i shpjegon ti gjërat, ka mundësi që keni magji në shtëpi dhe unë shoh se fjala është për magji. Unë shoh se duhet ta hulumtoni një orman të vjetër me rroba që i leni aty si të papërdorshme dhe kërkoj prej jush t'i nxirrni ato dhe në një xhep të një palltoje do të gjeni diçka si trekëndësh të mbështjellë. Hiqni ato prej rrobave dhe hidhni në një të digjen. Shoh se për dy javë

keni për t'u kthjellë dhe ka për të filluar shtëpia së funksionuari së mbari.

Ty do të të largohet frika, e vëllai do të hapet në shtëpi për të qenë komunikativ dhe i dobishëm.

E dua tjetër kënd. A ka kuptim të ndahem nga burri?

U fejova dhe u martova, por nuk po mundem ta dua burrin sikur kam menduar.

Tani jam bindur që e dua personin që e kam pasur dikur dhe me të jam takuar edhe pasi ai është martuar.

Në martesë nuk jam e lumtur, por nuk mund të ndiej siguri edhe nëse ndahem nga burri, sepse personi që e dua tash është martuar dhe nuk e besoj që ka për të mbajtur fjalën që ai ta lërë gruan për mua, meqë e kanë një fëmijë. Çka më këshillon?

"E"

Përgjigje:

Nuk shoh martesë me atë person. Ju keni qenë në lidhje dhe dëshira juaj është shkatërruar nga veprimi i tij dhe më nuk të them besoji. Mos u ndajë nga burri për martesë të re, sepse do të dështosh. Por, nëse ke vendosur të ndahesh për arsye se nuk je e lumtur me burrë, kjo është histori tjetër.

A kam pasur magji që e zgjedha burrin e tash jam e zhgënjyer?

Zonjë, kam shumë besim në ty. E ke ndihmuar shumë familjen time para disa vjetësh.

Jam e martuar, 27-vjeçare, jetoj në Mitrovicë. Kam disa dyshime në veten time apo edhe mund të më kenë bërë diçka kur dola të shihem me djalin që tani e kam burrë.

Kur e pashë mu duk i bukur, i pashëm. Por, ditën e parë kur dola me të si të fejuar mu duk krejt tjetër njeri dhe nuk kam pasur më dëshirë të takohem me të.

Por, pasi gabova e u fejova, mu desh ta mbulojë gabimin tim, duke u bërë gruaja e tij.

Të lutem, a do të jetoj me të deri në fund të jetës, bile t'i nënsh-trohem vullnetit të Zotit duke pranuar sakrificën?

"Me ty e dëshpëruar"

Përgjigje:

Ke pritur gjashtë të fejojesh dhe dëshira për t'u fejuar ka bërë që ai të të duket më i bukur në botë. E, pastaj e ke parë se ke gabuar...

Por, disa gabime janë të vonuara. Ajo që unë shoh është se do të jetoj me të dhe do i keni tre fëmijë.

Jam në krizë ta vras veten!

Jam 27-vjeçare, jetoj në rrethin e Prizrenit. Kam humbur çdo gjë për djalin që e dua dhe mendoj se më ka dashur edhe ai mua, meqë kemi qenë në lidhje nëntë vjet.

Nuk kemi pasur probleme, por ai para tre muajsh vendosi të shkojë në Zvicër, prej nga më nuk është kthyer e tani po dëgjoj fjalë se ai do të mbetet atje.

Për lidhjen tonë dinë të dy familjet tona, të cilat kanë bindjen se çdo gjë duhet ta zgjidhim unë dhe ai, pa ndërhyrje anash.

Të lutem, a do të jemi bashkë, sepse vetëm atë e dua?

"E dremitura"

Përgjigje:

Jeni qe nëntë vjet së bashku dhe e dinë familjet tuaja e ju nuk e keni zyrtarizuar fejesën apo nuk i keni dhënë vullë legjitimiteti dashurisë suaj!

Kjo vullë në dashuri normal se nuk është çdo gjë, por është një përafrim i mëtejme, por edhe një përgjegjësi më shumë në lidhjen tuaj.

Mendimi yt depresiv për ta dënuar vetveten është ideja më e keqe që mund ta bëni, por ti nuk je në udhë pa krye.

Nuk je në shtëpinë pa derë, prej nga nuk ke dalje. Ti ke sa të duash zgjidhje, meqë ai nuk ka hequr dorë prej teje.

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Dhe, nuk shoh se po heqë dorë, por shoh se ai po kërkon një siguri për ekzistencë e pa këtë ekzistencë ju nuk mund të bëni martesë, por nuk mundeni as ta doni njëri-tjetrin.

Jeta nuk është vetëm dashuri. Kup-timi i të dashuruarit nuk bazohet vetëm në të dashur, por shumë më shumë në ekzistencializëm, diçka që ju nuk e keni tani.

Gabimi yt është se e ke ndërprerë fakultetin, por ky gabim ende nuk e ka pikën në fund. Ti mund të rikthehesh në studime dhe ta aftësosh trurin për ta kryer obligimin.

Asgjë nuk ke humbur, sepse je në moshë shumë të mirë.

Shoh bashkimin tuaj në fund të rrugës...

Jam në rrugë pa dalje!

Paraqitem nga Franca. Jam grua, 26-vjeçare, e kam një fëmijë, por përsëri jam shtatzënë. Burri më ka braktisur, ndërkohë që ai ka krijuar familje tjetër.

Unë nuk kam qëndrim të rregullt, por nuk kam as ku të kthehem në familje.

Po pres ta lind fëmijën e dytë dhe, pastaj, nuk di rrugën që do marrë jeta ime...

"Errësira"

Përgjigje:

Ti duhet të përcaktohesh që t'i shkosh deri në fund mundësisë së statutit të azilantes. Me dy fëmijë zor është ta kesh në dorë fatin tënd ekzistencial, prandaj për momentin kjo është për ty zgjidhja më e mirë. E, sa i përket burrit, ai pas një kohe do të kthehet t'i kërkojë fëmijët e vet, por nuk shoh se as me atë tjetrën do të jetë diçka më mirë.



Gërrnaçi plak po më tradhton me gruan e 4 fëmijëve!

Burri jem, gërrnaçi plak, po më tradhton me femrën që e ka pasur në rini, në kohët e viteve 90. Ajo tash ishte nënë e 4 fëmijëve...

Jam në hall. Nuk po e ndiej veten mirë. Jam nënë e 4 fëmijëve. Qe 22 vjet jam e martuar me burrin tim. Por, qe 3 muaj e kam hetuar se po më tradhton me ish-dashnoren viteve 90. Edhe ajo ishte e martuar dhe ishte nënë e 4 fëmijëve!

SI E ZBULOVA SE IM BURRË MË TRADHTONTE?

Një mbrëmje shtatori, teksa punoja në kuzhinë, i erdhi tim burri në telefon një mesazh, derisa ai ishte në banjë duke u pastruar.

Nga kureshtja e hapa mesazhin dhe një femër ia bënte me dije se ende e donte si dikur...

Madje, i thotë se mbrëmë t'i kam dërguar edhe disa foto kur kemi qenë

bashkë...

Në mesazh ajo i thotë se mbrëmë e mora mesazhin tënd dhe shumë herë i kam lexuar ato fjalë të ëmbla që i kishe shkruar...

Dhe, kur burri im doli nga banjoja, i thashë çka je kah bën... I thashë se të erdhi një mesazh dhe e lexova...

Por, dilinxhia fare nuk u skuq në fytyrë! Si me shaka më tha se ka luajtur me të e asgjë më shumë...

UNË DY MUAJ NË GJILAN, BURRI IM DY MUAJ ME DASHNORE!

Por, e vërteta ishte krejt ndryshe. Unë gjatë verës isha në pushim në Gjilan, ku edhe qëndrova rrafsh 6 javë me fëmijë. Ai, gjatë asaj kohe, me gjasë, kishte rifilluar lidhjen me të dhe kishin

fle bashkë, sepse kur jam kthyer nga Gjilani në banesën tonë në Zvicër, dëgjova erën e një parfëmi tjetër në rrobat e tij, por nuk më ka shkuar mendja se ai gjatë asaj kohe më kishte tradhtuar...

Tash, kur e kam mësuar të vërtetën, kam mbetur në udhëkryq: Të heshtë a të ndahem?!

Dhe, po të heshtë, si të heshtë kur zemra më qanë e shpirti me dhemb?! Por, edhe të ndahem, si të ndahem?!

Do i plotësohet dëshira lavires që të jetë me burrin tim gjithmonë!

Mirëpo, edhe kështu si jam tash boll keq jam. Po mërzitem... Pështillem sa andej e sa këndeje...

Po mundohem fëmijëve t'u jem sa më pranë, në mënyrë që ta harroj atë lavire, se ndryshe s'di si ta quaj...

Miradije B., Zvicër



SHERWOOD

Resorts and Hotels

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

www.sherwoodhotels.com.tr
+90 444 88 07